

## **Projekti i rregullimit "Papyrus"**

### **Kriterët dhe lista e dokumenteve të nevojshme**

---

Projekti "Papyrus" ju drejtohet personave që i plotësojnë kriterët dhe mund të sjellin të gjithë dokumentet e kërkuara sikurse ceket në listën e mëposhtme. Për bazën legale të artikullit 30, paragrafi b i ligjit për të huaj.

Të gjithë personat që kanë një procedurë azili në vazhdim ose janë qytetarë të një shteti të Bashkimit Europian nuk mund të aplikojnë për një kërkesë brenda projektit "Papyrus".

Me pak fjalë, kriterët që duhet të përmbushen:

- 5 vite qëndrimi për familjet me fëmijë në shkollë, 10 vite për të tjerët
- të ketë një ose më shumë vende pune
- të jetë financiarisht i pamvarur
- të ketë nivelin A2 (në të folur) në frengjisht
- të mos jetë i dënuar për vepër penale

\* \* \* \* \*

Që të pranohet nga autoritetet, çdo dosje e dorëzuar duhet të ketë këto dokumente :

**Dokumentet me të zezë janë të domosdoshëm menjëherë, të tjerët mund të sillen në masë të mundësisë.**

#### **Dokumenti 1 – Punësimi dhe identiteti**

Ju duhet të dëshmoni që keni një / shumë vend/e pune dhe të jeni në gjendje për të përmbushur nevojat e juaja, në qoftë se është e nevojshme edhe ato të familjës suaj.

- **Formulari i posaçëm për njoftim të punës dhe punëdhënësit, i mbushur nga i punësuar për çdo punëdhënës**, i bashkangjitur, në rastin egzistues, të formularit M nga "OCPM" edhe për çdo punëdhënës (shiqoni kopjen në aneks)
- **Formulari P nga "OCPM" për bashkeshort/e pa aktivitet fitimprues dhe për çdo fëmijë** (shiqoni kopjen në aneks)
- **Kopja e certifikatës së lindjes për secilin fëmijë**
- **Pasaportë të vlefshme për çdo person**  
Në rastin e mungesës së pasaportës, permanencat do ju këshillojnë

#### **Dokumenti 2 – Kohëzgjatja e qëndrimit**

Familjet me më së paku një fëmijë në shkollim : ju duhet të dëshmoni pesë (5) vite minimum të qëndrimit të vazhdueshëm në Gjenevë, minimum njëri nga anëtarët e familjës.

Beqarët, çiftet pa fëmijë ose çiftet me fëmijë jo në shkollim : ju duhet të dëshmoni dhjetë (10) vite qëndrimi të vazhdueshëm në Gjenevë, minimum njëri nga anëtarët e familjës.

**Janë të pranuar si provë e qëndrimit (një për vitë qëndrimi është e nevojshme) <sup>1</sup>:**

- Ekstrakti AVS
- Dëshmia e kontributit LPP

---

<sup>1</sup> Për dokumentët në lidhshmëri me qëndrimin, dokumentët në lidhshmëri me familjet (letra nga autoritet e shkollimit, parashkollimit, nga kurse sportive, etj.) adresat që mbajnë emrin e prindërve në parim janë të pranueshme si provë e qëndrimit të prindërve.

- Certifikata e taksave
- Listat e pagave
- Kontrata e punës
- Kontrata e qirasë
- Dokumentet e procedurave në lidhje me punësimin
- Provat e pagesës së shtesave familjare të aplikant-it/es
- Certifikata e shkollës, librezat e notave
- Dokumentet e shkollimit (ose parashkollimit, kurseve të sportit, kurseve të muzikës, etj.) adresat që mbajnë emrin e prindërve (jo thjeshtë rrethore)
- Certifikata e ndjekjes së një kursi të gjuhës
- Provat e pagesës së shërbimit shëndetësor nga aplikant-i/ja (nga ai/ajo ose nga fëmijët e tyre)
- Dokumentet e Sigurimit Shëndetësor (polica e sigurimit, vendimi i subvencionit)
- Polica e sigurimit (përgjegjësia civile, aksident zjarri, punë shtëpie, etj.)
- Mujore e transportit publik (TPG) nga aplikant-i/ja ose njëri nga fëmijët e tyre
- Certifikatë e pjesmarjes individuale në një shoqatë
- Ekstrakti i llogarive bankare ose postale në emrin e aplikant-it/es që tregon tërheqjen ose pagesën e rregullt në bizneset lokale
- Provë e pagesës në Western Union nga aplikant-i/ja
- Fakturë me emër të shëndetësisë, fakturë e konsumimit energjetik/ telefonik

Në qoftë se nuk keni provë qëndrimi për një ose disa vite, informohuni pranë permanencës.

### **Dokumenti 3 – Pamvarësia e plotë në nivelin financiar**

Ju duhet të dëshmoni që jeni në tërësi i/e pamvarur financiarisht dhe që keni të ardhura të mjaftueshme për ju, në qoftë se është e nevojshme edhe për familjen tuaj.

- **Certifikata e jo ndjekjes përmbarimore për çdo të rritur**  
Në rastin e ndjekjes përmbarimore, permanencat do ju këshillojnë
- **Certifikata e jo ndihmesës nga "Hospice Général" për çdo të rritur**  
Nëse është e nevojshme, dëshmitë e listave të pagave

### **Dokumenti 4 – Integrimi i suksesshëm**

Integrimi do të jetë shqyrtuar përbaze të nivelit të gjuhës frënge dhe nëse është e nevojshme, dëshmitë që fëmijët ndjekin një shkollim të rregullt.

- **Certifikata e nivelit të gjuhës frënge A2 (në të folur) për çdo të rritur.**  
Në rastin e mungesës së certifikatës, një vlerësim i njohurive apo regjistrimi në kurs të frengjishtes që i përket nivelit A2 mjafton. Permanencat do ju këshillojnë
- **Nëse është e nevojshme, certifikata e shkollimit për fëmijët.**

### **Dokumenti 5 – Respektimi i ligjit**

Ju duhet të dëshmoni që ju nuk jeni pjesë e një dënimi për vepër penale dhe që nuk keni kryer një vepër të rëndë.

- **Ekstrakt nga dosja penale**  
Në rastin e dënimit, permanencat do ju këshillojnë.

# OPÉRATION PAPYRUS

## RÉGULARISATION DES TRAVAILLEURS-EUSES SANS-PAPIERS

### Permanences d'information et constitution des dossiers

L'Opération Papyrus permet de régulariser les personnes sans-papiers qui travaillent et sont intégrées à Genève. Vous pensez être concerné-e ? Vous avez des questions ? Venez vous informer auprès d'une des trois permanences spécifiques, nous pourrons répondre à vos questions et vous donner toutes les explications nécessaires : quels sont les critères exacts à remplir ? Quels documents devez-vous amener ? Comment déposer une demande ? Quelle est la procédure à suivre ? **Ne prenez pas de risques inutiles, nous pouvons vous aider !**

#### Associations membres du Collectif de soutien aux sans-papiers :

- Mardi de 10h à 13h, au CSP, 14, rue du Village-Suisse
- Mercredi de 16h à 20h, à l'EPER, 1, rue de l'Orangerie

#### Syndicat SIT (16, rue des Chaudronniers) :

- Lundi de 14h à 20h
- Jeudi de 14h à 17h
- Vendredi de 9h à 12h

#### Syndicat Unia (5, chemin Surinam) :

- Mardi de 17h à 19h
- Mercredi de 16h à 18h
- Jeudi de 10h à 12h et de 16h à 19h
- Vendredi de 16h à 18h
- Samedi de 14h à 16h

**Attention, ces horaires sont valables à partir du 6 mars 2017. Après le 30 juin 2017, ces horaires pourraient changer : renseignez-vous auprès des associations ou syndicats concernés.**